



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 08.01.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 06.01.2019 të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: "Murseli" Company "SH.P.K.; N.T.SH. " Krasniqi" Dogana Kaçanike**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Rrënimi i objekteve të ndërtuara pa leje."**, me Nr. të Prok: **616-18-8990-5-2-1** dhe numër te brendshëm **616 18 146 521** nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e **Grup i Operatorëve Ekonomik: "Murseli" company "SH.P.K.; N.T.SH. " Krasniqi" Dogana Kaçanik** të dt. 06.01.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Rrënimi i objekteve të ndërtuara pa leje."**, me Nr. të Prok: **616-18-8990-5-2-1** dhe numër te brendshëm **616 18 146 521**, kundër *Njoftimit për tenderues te pasuksesshëm* te AK –së, të datës 31.12.2018.
2. Vërtetohet vendimi i AK i *njoftimit për dhënje te kontratës* të publikuar me datë: 31/12/2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit per tenderin "Rrënimi i objekteve të ndërtuara pa leje."*, me Nr. të Prok: **616-18-8990-5-2-1** dhe numër te brendshëm **616 18 146 521**, Numër te Brendshëm **616-18-015-2-1-1**, sipas Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhenje te kontratës me datën: 31.12.2018.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Grup i Operatorëve Ekonomik: "Murseli" Company SH.P.K.; N.T.SH. " Krasniqi" Dogana Kaçanik me datë 06.01.2019, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Rrënimi i objekteve të ndërtuara pa leje."**, me Nr. të Prok: **616-18-**

8990-5-2-1 dhe numër te brendshëm 616 18 146 521. Autoriteti Kontraktues, me datë 08.01.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Lidhur me pretendimin se OE i rekomanduar per kontrate ka ofertuar me çmime ab normalishte te uleta ne disa pozicione, Autoriteti Kontraktues ju njofton se ky pretendim nuk qendron pasi qe sipas LPP dhe Udhezuesit per Prokurim Publik ezistojn kriteret qe duhet permbushur per ti cilesuar si çmime ab normalishte te uleta. Po ashtu ju njoftojmë se qellimi i ketij ligji është te siguroj menyren me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytezimit te fondeve publike, si dhe neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti par. 1 qe thotë se: te gjitha autoritetet kontraktuese, jane te obliguara që të sigurojnë që fondet publike të eperdoren ne menyren me ekonomike, njekohesishte duke marrë ne konsiderate qellimin dhe lenden e prokurimit.

Ne Njoftimin per kontrate ne piken II.1.10 dhe ne Dosjen e tenderit te FDT pika 2.6 ka qene e dhene informata per vleren e parashikuar te tenderit. Vlera e parashikuar e tenderit ka qen 150,000.00 euro ndersa ju e keni tejkualuar kete vlerë dhe se vlera juaj e ofertes eshte 185,200.00 euro.

- Lidhur me pretendimin se OE i rekomanduar per kontrate nuk ka mund te ofroj listen e projekteve te realizuara siq ka kerkuar Autoriteti Kontraktues. Ky pretendim nuk qendron ngase OE i rekomanduar per kontrate ne oferten e tij ka dorezuar listen e projekteve – Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit si dhe ka dorezuar kopjet e kontratave dhe referencave per pune te ngjashme ashtu siq eshte kerkuar ne Njoftimin per kontrate dhe ne Dosjen e tenderit.

- Lidhur me pretendimin se OE i rekomanduar per kontrate nuk ka ofruar deshmi lidhur me pajisjet e kerkuara - nu ka ofruar librezat dhe DUD-at doganor per pajisjet e kerkuara. Ky pretendim po ashtu nuk qendron pasi qe OE i rekomanduar per kontrate i ka ofruar te gjitha deshmit e kerkuara, ka ofruar librezat dhe DUD-at dioganor per te gjitha pajisjet e ofruara ashtu siq eshte kerkuar ne Njoftimin per Kontrate dhe ne Dosjen e Tenderit.

AK – komisioni i vleresimit, ka bere vleresimin e ofertave gjithnje duke u mbeshtetur ne LPP dhe ne Rregullat e Udhezuesit Operativ per prokurim Publik.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit